



PSIKOLOGËT NË SHKOLLA

RAPORT MONITORIMI

Shtator 2025



AUTOR
Ritvana Hajdari

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	3
2. METODOLOGJIA	5
3. KORNIZA LIGJORE DHE RREGULLATORE	5
3.1 Arkitektura normative	5
3.2 Standardet ndërkombëtare për shërbimet e shëndetit mendor në shkolla 10	
4 PRESPEKTIVAT E AKTORËVE TË NDRYSHËM MBI SHËRBIMET PSIKOLOGJIKE NË SHKOLLË	13
4.1 Perspektiva e nxënësve mbi shërbimin psikologjik në shkollë	13
4.2 Perspektiva e mësuesve mbi shërbimet psikologjike në shkollë	14
4.3 Perspektiva e psikologëve.....	16
4.4 Perspektiva e pedagoges së masterit në psikologji shkollore	19
5 VLERËSIM KRITIK DHE ANALIZË	21
REKOMANDIMET.....	26



1. HYRJE

Në kontekstin shqiptar të viteve të fundit, çështjet e shëndetit mendor dhe mbështetjes psikosociale të fëmijëve dhe të rinjve janë bërë gjithnjë e më të dukshme sidomos pas pandemisë COVID-19, duke reflektuar jo vetëm ndryshimet në strukturën sociale, por edhe sfidat e një sistemi arsimor që shpesh mbart më shumë barrë se sa kapacitete reale. Shkolla, si institucioni kryesor i socializimit dhe formimit, është hapësira ku manifestohen në mënyrë të drejtpërdrejtë vështirësitë e zhvillimit psiko-emocional dhe marrëdhëniet ndërpersonale të nxënësve. Fenomene si bullizmi, dhuna ndërmjet bashkëmoshatarëve, rritja e simptomave të ankthit dhe depresionit, vështirësitë e përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta, si dhe prirja për izolim social, tregojnë për një nevojë të thellë dhe të strukturuar për shërbime psikosociale funksionale brenda institucioneve arsimore. Këto të dhëna ilustronë qartë hendekun mes nevojës reale për mbështetje psikosociale dhe burimeve që sistemi arsimor ofron aktualisht. Në këtë kontekst, shërbimet psikosociale në shkolla nuk janë më luks, por një domosdoshmëri, pasi ato lidhen drejtpërdrejt me të drejtën e fëmijës për arsim cilësor dhe me të drejtën për mbrojtje sociale. Kjo mospërputhje mes nevojës së qartë dhe reagimit institucional e ka bërë këtë temë jo vetëm të rëndësishme, por edhe urgjente për analiza dhe politika të reja.

Ky raport synon të analizojë shtrirjen dhe cilësinë e shërbimeve psikosociale në arsimin parauniversitar në Shqipëri, me fokus tek kushtet konkrete të punës së profesionistëve që ofrojnë këto shërbime, veçanërisht psikologët shkollorë. Psikologu, si figurë profesionale e specializuar, ka një rol kyç në identifikimin e hershëm të shqetësimeve psiko-emocionale, në ndërhyrjet parandaluese dhe në mbështetjen e fëmijëve e të rinjve që përballen me vështirësi. Ai gjithashtu ndërmjetëson marrëdhëniet midis nxënësve dhe mësuesve, si dhe krijon ura komunikimi mes shkollës dhe familjes. Në Shqipëri, megjithatë, roli i psikologut shpesh kufizohet nga faktorë strukturorë që lidhen me mbingarkesën, mungesën e resurseve dhe mbështetjes së rregullt



institucionale. Ky raport vendos në qendër pyetjen kritike: Sa efektive janë sot shërbimet psikosociale në shkollat shqiptare dhe cilat janë kufizimet që pengojnë realizimin e potencialit të tyre?

Në nivel shoqëror, shëndeti mendor i të rinjve në Shqipëri ndikohet nga një sërë faktorësh të ndërlidhur si, pamundësitë ekonomike, emigracioni i prindërve, mungesa e perspektivës për punësim, presioni akademik dhe ndikimi i rrjeteve sociale. Psikologu shkollor, në këtë kuadër, përfaqëson hallkën e vetme profesionale të specializuar brenda institucionit arsimor për adresimin e këtyre sfidave. Megjithatë, kushtet në të cilat ata punojnë shpesh janë të papërshtatshme. Këto kufizime reduktojnë ndjeshëm mundësinë e ndërhyrjeve parandaluese dhe e shndërrojnë shërbimin psikosocial nga një instrument aktiv i mbështetjes në një mekanizëm formal, i pranishëm vetëm në nivel të dokumentuar. Për pasojë, analiza e gjendjes aktuale merr rëndësi të veçantë, pasi ndihmon të kuptohen jo vetëm boshllëqet, por edhe pasojat që këto boshllëqe kanë për mirëqenien e fëmijëve dhe për funksionimin e sistemit arsimor në tërësi. Shëndeti mendor i fëmijëve dhe i të rinjve nuk është thjesht një çështje individuale apo arsimore, është një element kyç i zhvillimit social dhe ekonomik të vendit. Një sistem arsimor që nuk garanton mbështetje psikosociale rrezikon të prodhojë gjenerata të dhunshme me tendenca agresiviteti deri në kriminale, të brishta, më pak të afta për të përballuar sfidat e jetës dhe për të kontribuar në shoqëri. Sipas një raporti nga UNICEF¹ dhe RTI rezultatet sugjerojnë që për çdo dollar të investuar në shërbimet psikosociale, përfitimet e shmangies së humbjeve të ardhshme mund të jenë shumëfishë varësisht nga lloji i ndërhyrjes. Në këtë kuptim, çështja e shërbimeve psikosociale në shkolla nuk mund të shihet si një detaj teknik, por si një prioritet politik dhe strategjik për të ardhmen e Shqipërisë.

¹ UNICEF. (2022). The benefits of investing in school-based mental health support. UNICEF. <https://www.unicef.org/media/145701/file/The%20benefits%20of%20investing%20in%20school-based%20mental%20health%20support.pdf>



2. METODOLOGJIA

Ky raport mbështetet në një qasje të kombinuar metodologjike, që ndërthur analiza cilësore me shqyrtimin e dokumenteve ligjore dhe institucionale. Thelbi i mbledhjes së të dhënave cilësore është metoda e intervistës gjysmë të strukturuar, e cila ka mundësuar nxjerrjen në pah të përvojave konkrete dhe perceptimeve të aktorëve kryesorë të shkollës. Në total u realizuan intervista me 53 nxënës, 34 mësues, 17 psikologë shkolle si dhe me një pedagoge të programit të Masterit në Psikologji Shkollore pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës. Përzgjedhja e shkollave ku u zhvilluan intervistat u bë me synimin për të reflektuar diversitetin urban e rural dhe për të evidentuar specifikat rajonale, duke krijuar një pasqyrë sa më gjithëpërfshirëse. Analiza e intervistave u realizua përmes analizës tematike, ku njësitë kuptimore u koduan dhe u sintetizuan në tema të përsëritura lidhur me shtrirjen e shërbimit, kushtet e punës, rolin profesional, bashkëpunimin ndëraktor, aksesueshmërinë dhe perceptimin e shërbimit nga përfituesit. Paralelisht, u shqyrtua korniza ligjore dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, të cilat përcaktojnë mënyrën se si konceptohet dhe formalizohet shërbimi psikosocial në shkollë. Ky kombinim i të dhënave empirike me analizën e kornizës rregullatore i ka dhënë raportit një bazë të fortë për të kuptuar hendekun midis asaj që përcakton ligji dhe mënyrës se si ky rol zbatohet realisht në terren.

3. KORNIZA LIGJORE DHE RREGULLATORE

3.1 Arkitektura normative

Baza formale e shërbimit psikosocial (SHPS) në Shqipëri ngrihet mbi Ligjin nr. 69/2012 "Për arsimin parauniversitar"², i cili ngarkon institucionet arsimore me detyrimin për të ofruar një mjedis të sigurt, gjithëpërfshirës dhe mbështetës për zhvillimin psiko-social të nxënësve. Ky ligj e njeh SHPS-në si pjesë të stafit mbështetës dhe i hap rrugë

² Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. (2021). Ligji nr. 69/2012 për arsimin parauniversitar, i ndryshuar. Arsimit Parauniversitar.
<https://arsimiparauniversitar.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/LIGJI-69-2012-I-NDRYSHUAR.pdf>



akteve nënligjore që e operacionalizojnë këtë detyrim (Ligji nr. 69/2012, Neni 20). Mirëpo, vetë ligji qëndron në nivel parimor, ai nuk fiksion norma numerike për raportin psikolog–nxënës, nuk detajon standarde cilësie dhe nuk përcakton mekanizma monitorimi e sanksionimi pra, e lë “peshën e vërtetë” te urdhrat dhe udhëzuesit e MAS/ASCAP. Kjo e bën arkitekturën formalisht koherente, por me risk të lartë zbatimi nëse hallkat e poshtme (urdhra, udhëzues, instrumente cilësie) nuk mbështeten me buxhet, organika dhe auditim të rregullt (Ligji nr. 69/2012).

Urdhri nr. 313, datë 20.10.2020³, është dokumenti që operacionalizon shërbimin psikosocial në shkolla. Ai e përcakton ciklin e punës së psikologut në katër faza: parandalim, vlerësim, ndërhyrje dhe referim, e pozicionon specialistin si hallkë ndërmjet shkollës, familjes dhe rrjeteve të referimit dhe ngarkon zyrat arsimore vendore me supervizim e koordinim. Ky ishte një hap i madh përpara, sepse e zhvendosi rolin e psikologut nga një “figurë formale” në një shërbim me mision dhe përgjegjësi të qarta. Megjithatë, urdhri mbetet procedural dhe jo performativ nuk vendos tregues të matshëm të rezultateve, nuk përcakton ngarkesën optimale të punës dhe nuk përmban sanksione të qarta për moszbatim. Kjo do të thotë se, edhe pse rregullimi ligjor ekziston, psikologët në terren shpesh përballen me mbingarkesë dhe mungesë mbështetjeje për të realizuar funksionet e përshkruara.

Ndryshimi me ⁴Urdhrin nr. 110, datë 13.03.2025 afrimon se MAS po “prek” 313-ën në kohë reale një shenjë qeverisje aktive. Teksti i 110-ës korrekton dispozita operative dhe sqaron procedura (p.sh. emërim/pezullim/largim), duke ulur hapësirat për interpretime të ndryshme ndër ZVAP/DRAP. Ky rregullim rrit sigurinë juridike për personelin e SHPS dhe ofron bazë më të fortë për menaxhimin e individëve. Gjithsesi, është përshtatje e kornizës, jo reformë

³Ministria e Arsimit. (2020, 20 tetor). Urdhër nr. 313, dt. 20.10.2022
<https://drive.google.com/file/d/1E5-z20C7AOVwp9mQ7nsTBaotuXjoTYeT/view>

⁴Ministria e Arsimit. (2025, 13 mars). Urdhër nr. 110, dt. 13.03.2025
<https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2025/05/urdher-nr.110-dt.13.03.2025-1.pdf>



kapacitetesh nuk trajton ngarkesën numerike, hapësirat konfidenciale, supervizimin periodik apo buxhetimin aty ku “djeg” zbatimi. Prandaj, 110-a duhet parë si mjet shoqërues, jo si instrument kyç i ritjes së efektivitetit.

Risi madhore sjell Urdhri nr. 483, datë 19.09.2025⁵, i cili fiksion për herë të parë raporte të detajuara psikolog/punonjës social nxënës sipas madhësisë së shkollës dhe karakteristikave të popullatës (p.sh. +1 specialist për ≥8 nxënës me AK; dy specialistë për >450 nxënës; një specialist i dedikuar për shkollat speciale; mbulim i përbashkët për 80–250 nxënës në shkolla shumë të vogla). Kjo e transformon objektivin nga “të kemi SHPS-në” në “të kemi SHPS me densitet minimal të verifikueshëm”, duke i dhënë MAS/ZVAP/DRAP një metër transparent për planifikim organikash dhe kontroll (MASR 2025b). Pikërisht sepse 483-a është ambicioze, ajo zhvesh tensionin klasik normë–kapacitet, pa buxhet të mjaftueshëm, kontrata me kohë të plotë dhe treg pune që furnizon psikologë të kualifikuar, rreziku është “përmbushje formale” (p.sh. mbulim me kohë të pjesshme në disa shkolla) pa ndryshuar realisht aksesin dhe cilësinë. Pra, 483-a është “gjenerator llogaridhënje”, por vetëm nëse pasohet nga politika financiare dhe rekrutuese konsistente.

Në planin profesional, ASCAP ka dy shtylla, e para **Udhëzuesi i praktikës së punës⁶ (2022)**.

Ky manual përcakton mënyrën se si duhet të punojnë psikologët shkollorë, duke standardizuar hapat kryesorë: parandalimin, vlerësimin, ndërhyrjen dhe referimin. Ai përfshin edhe mënyrën e dokumentimit, bashkëpunimin me prindërit dhe mësuesit, si dhe protokollet për raste bullizmi, dhune, braktisjeje apo emergjencash. Në këtë mënyrë, puna e psikologut bëhet më e njëtrajtshme në të gjitha shkollat, më e lehtë

⁵ Ministria e Arsimit. (2025, 19 shtator). Urdhër nr. 483, dt. 19.09.2025
<https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2025/09/urdher-483-dt-19.09.2025.pdf>

⁶ ASCAP. (2022). Udhëzuesi i SHPS
<https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2022/07/Udhezuesi-i-SHPS.pdf>



për t'u gjurmuar dhe lidhet drejtpërdrejt me planin vjetor të shkollës dhe raportet periodike. Së dyti Korniza e vlerësimit⁷ (2025). Ky është një instrument auditi që përdor tregues të qartë për strukturën, procesin dhe rezultatet e punës. Vlerësimi bëhet në një shkallë nga 1 deri në 4 dhe kërkon prova konkrete (plane pune, regjistra rastesh, referime, protokolle bashkëpunimi, raporte supervizimi). Kjo kornizë e zhvendos shërbimin psiko-social nga thjesht "të qenët prezent" në shkollë, tek matja e performancës reale, duke bërë të mundur krahasimin e rezultateve si me kalimin e kohës, ashtu edhe mes shkollave të ndryshme. Analitikisht, këto dy instrumente i japin kuptim praktik Urdhrave 313/483, të parin e bëjnë manual pune, të dytin e kthejnë në llogaridhënie me indikatorë. Por, fuqia e tyre varet nga supervizimi i rregullt i ZVAP/DRAP dhe nga kapacitetet në shkolla (kohë e mjaftueshme pune, hapësira konfidenciale, ngarkesë e menaxhueshme). Pa këto, edhe instrumenti më i mirë i cilësisë rrezikon të ngelë "dosje".

Rregullimi profesional dhe etik i profesionistëve mbështetet nga ligjet sektoriale si Ligji nr. 40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë"⁸ dhe Ligji nr. 163/2014 "Për Urdhrin e Punonjësve Socialë"⁹, që vendosin kriteret e licencimit, standardet etike dhe mekanizmat disiplinorë. Kjo arkitekturë rrit llogaridhënien profesionale dhe krijon bazën për zhvillim të vazhdueshëm profesional. Këto ligje janë të domosdoshme për rregullimin profesional dhe për rritjen e standardeve etike. Ato kontribuojnë në forcimin e profilit profesional të psikologut dhe punonjësit social. Megjithatë, roli i tyre është më shumë disiplinor dhe rregullues, pa hyrë në problematikat e kushteve të punës në shkollë. Për këtë arsye, ndikimi i tyre real në funksionimin e SHPS është i tërthortë.

⁷ ASCAP. (2025). Korniza e Vlerësimit të Shërbimit Psiko-Social

<https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2025/01/Korniza-e-Vleresimit-te-sherbimit-psikosocial.pdf>

⁸ Urdhri i Psikologut. (2016). Ligji i Urdhrit të Psikologut

<https://www.urdhriipsikologut.al/wp-content/uploads/2019/10/Ligji-i-Urdhrit-te-Psikologut.pdf>

⁹ Urdhri i Punonjësve Socialë. (2014). Ligji i Urdhrit të Punonjësve Socialë

<https://urdhripunonjesvesociale.al/wp-content/uploads/2022/12/Ligji-Urdheri-i-PS-updated-3.pdf>



Plani i Veprimit për Shëndetin Mendor 2023–2026¹⁰ i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) e njeh shprehimisht SHPS-në si pjesë të rrjetit të integruar të kujdesit psikosocial (MSHMS 2023). Në teori, kjo nënkupton që rastet e rënda duhet të kenë një rrugë të qartë referimi nga shkolla te qendrat e kujdesit parësor dhe shërbimet komunitare. Por në praktikë, këto ura janë ende të dobëta, shumë shkolla nuk kanë protokolle funksionale për referim, dhe komunikimi mes institucioneve shpesh mbetet informal. Ky është një shembull tipik i hendekut midis planit strategjik dhe realitetit të terrenit.

Sot, Shqipëria ka një kornizë moderne dhe koherente në letër ligj bazë, urdhra që formalizojnë rolet (313) dhe normojnë densitetin minimal (483), manual profesional që unifikon praktikën (ASCAP 2022) dhe instrument cilësie me indikatorë të verifikueshëm (ASCAP 2025). Kjo është një arkitekturë e plotë për standarde dhe llogaridhënie. Por “testi i vërtetë” do të jenë tri gjëra:

- a do të financohen organikat sipas 483-ës;
- a do të institucionalizohet supervizimi dhe auditimi sipas Kornizës 2025,
- a do të funksionojë ura me shëndetin publik sipas Planit 2023–2026. Pa këto, një psikolog “në listë” që mbulon më shumë se një shkollë, pa kohë për parandalim, pa hapësirë konfidenciale dhe pa rrugë klinike efektive, mund të kthehet në një psikolog pa impakt. Ky është “hendeku normë–realitet” që duhet matur dhe adresuar me të dhëna publike periodike (p.sh., në Vjetarin Statistikor), përndryshe korniza do të mbetet e shkëlqyer “de jure”, por e brishtë “de facto”.



¹⁰ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2023). *Plani i Veprimit për Shëndetin Mendor 2023–2026* <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/Plani-i-Veprimit-per-Shendetin-Mendor-2023-2026.pdf>

3.2 Standardet ndërkombëtare për shërbimet e shëndetit mendor në shkolla

Korniza ndërkombëtare për shërbimet e shëndetit mendor në shkolla është formësuar kryesisht nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh), UNICEF, UNESCO dhe rrjete rajonale si "Schools for Health in Europe" (SHE). Këto organizata theksojnë vazhdimisht se ofrimi i mbështetjes psikosociale në shkolla duhet të shihet si pjesë e një sistemi të gjerë qeverisje në fushën e arsimit dhe shëndetit dhe jo thjesht si një shërbim i izoluar. Udhëzuesi i OBSh-së¹¹ mbi shërbimet e shëndetit në shkolla (2021) propozon qasjen "Whole-School Approach", ku shëndeti mendor integrohet në politikat e shkollës, në mjedisin fizik dhe social, në kurrikulën e aftësive jetësore, në partneritetet me familjen dhe shërbimet komunitare, si dhe në mekanizmat e monitorimit dhe llogaridhënies. Në të njëjtën linjë, UNICEF¹² përmend pesë shtylla themelore: politika mbrojtëse në shkollë, mjedise të sigurta e mbështetëse, zhvillim aftësish për jetën, shërbime të aksesueshme dhe reagim të shpejtë, si dhe sisteme monitorimi dhe vlerësimi efektiv. Nga pikëpamja e politikave publike, theksi kryesor është se standardet ndërkombëtare nuk kufizohen vetëm te numri i psikologëve, por kërkojnë krijimin e një sistemi koherent që garanton cilësi dhe barazi. Megjithatë, shoqatat profesionale ofrojnë tregues numerikë të cilët përdoren gjerësisht si referencë në politikëbërje. Shoqata Kombëtare e Psikologëve Shkollorë në SHBA¹³ (NASP) rekomandon një psikolog për çdo 500 nxënës, ndërsa Shoqata Amerikane e Këshilltarëve Shkollorë¹⁴ (ASCA) sugjeron një psikolog për çdo 250 nxënës (NASP/ASCA, 2023; ASCA, 2024). Këto standarde nuk janë të detyrueshme në shkollë globale, por krijojnë një bazë transparente mbi të cilën shtetet mund

¹¹ World Health Organization. WHO Guideline on School Health Services. Geneva: WHO, 2021.

<https://www.who.int/publications/i/item/9789240029392>

¹² UNICEF. Promoting and Protecting Mental Health in Schools and Learning Environments. New York: UNICEF, 2021.

<https://www.unicef.org/media/126821/file/Promoting%20and%20protecting%20mental%20health%20in%20schools%20and%20learning%20environments.pdf>

¹³ Lipkin, Sharon. "Needed: More School Psychologists." Phi Delta Kappan, kappanonline.org.

<https://kappanonline.org/needed-more-school-psychologists-lipkin-nasp>

¹⁴ American School Counselor Association. "School Counselor Roles & Ratios." Accessed <https://www.schoolcounselor.org/About-School-Counseling/School-Counselor-Roles-Ratios>



të masin boshllëqet e tyre. Një tjetër dimension i rëndësishëm është përmbajtja dhe shtrirja e shërbimeve. OBSH dhe UNESCO rekomandojnë një model të shkallëzuar promovim universal për të gjithë nxënësit, ndërhyrje parandaluese për ata që janë në rrezik dhe mbështetje të specializuar ose referim për nxënësit me nevoja të identifikuara. UNICEF thekson se këto shërbime duhet të jenë të përshtatura me moshën, të aksesueshme pa pengesa dhe të lidhura ngushtë me rrjetet e shërbimeve shëndetësore dhe sociale në komunitet. CDC¹⁵, në Udhëzuesin e saj të vitit 2023, përkthen këto parime në gjashtë strategji të zbatueshme për shkollat, përfshirë forcimin e ndjenjës së lidhjes, trajnimin e stafit dhe protokollet e krizës. Në Evropë, rrjeti SHE¹⁶ në vitin 2021 ka nxjerrë një material udhëzues që nënvizon rëndësinë e klimës shkollore, pjesëmarrjes dhe gjithëpërfshirjes si tregues kryesorë të promovimit të shëndetit mendor. Një shtyllë qendrore e këtyre standardeve është sigurimi i cilësisë dhe llogaridhënia. OBSH ka paralajmëruar se shumë programe dështojnë për shkak të mungesës së monitorimit sistematik dhe mungesës së financimit të qëndrueshëm. UNICEF kërkon krijimin e sistemeve të qarta kombëtare të monitorimit që matin shtrirjen, cilësinë dhe efektivitetin e shërbimeve. CDC propozon indikatorë specifikë të rezultateve, si rritja e lidhjes me shkollën, ulja e incidenteve të sjelljes dhe përmirësimi i angazhimit akademik. Këto sisteme nuk janë vetëm mjete teknike, por edhe mekanizma llogaridhënie që sigurojnë që prania e një psikologu në shkollë të mos mbetet një kërkesë formale, por të përkthehet në ndikim real mbi mirëqenien e nxënësve. Së fundi, standardet ndërkombëtare vendosin theksin edhe te financimi dhe barazia. Shtetet që arrijnë mbulim më të gjerë kombinojnë fonde të dedikuara për shërbimet psikosociale me mekanizma barazie që orientojnë më shumë burime drejt shkollave në nevojë. Ky është parimi i

¹⁵ Centers for Disease Control and Prevention. Promoting Mental Health and Well-Being in Schools: An Action Guide for School and District Leaders. Atlanta: CDC, 2023.

https://www.cdc.gov/mental-health-action-guide/media/pdfs/DASH_MH_Action_Guide_508.pdf

¹⁶ Schools for Health in Europe (SHE). Mental Health Promotion in Schools: Factsheet 7 (2021).

<https://www.schoolsforhealth.org/sites/default/files/editor/fact-sheets/factsheet-7-mental-health-2021-new.pdf>



“universalizmit progresiv”, ku të gjithë nxënësit marrin një paketë bazë të mbështetjes, ndërsa grupet vulnerabël përfitojnë mbështetje më intensive. Në kontekstin evropian, Këshilli i Evropës¹⁷ e ka lidhur shëndetin mendor në shkolla me kulturën demokratike dhe pjesëmarrjen, duke theksuar se mbështetja psikosociale duhet të shkojë paralelisht me forcimin e agjencisë së nxënësve.

Në krahasim me këto standarde, realiteti shqiptar paraqet boshllëqe të dukshme. Shqipëria ka ndërmarrë disa hapa ligjorë dhe rregullatorë për praninë e psikologëve në shkolla, por sistemi mbetet i fragmentuar dhe i kufizuar. Shërbimi shpesh reduktohet në faktin e thjeshtë që një psikolog është i pranishëm në shkollë, pa garantuar raportet e duhura numerike, pa qasje multidisiplinare dhe pa mbrojtje të rolit profesional. Më e rëndësishmja, mungon një qasje e integruar në të gjithë shkollën, e cila sipas udhëzimeve të OBSH-së dhe UNICEF-it është parakusht për cilësi dhe efektivitet. Kjo bën që shërbimet në Shqipëri të jenë më shumë reaktive sesa parandaluese, të mbështetura te individi dhe jo te struktura, dhe me një ndikim të kufizuar në mirëqenien afatgjatë të nxënësve. Ndërkohë që standardet globale theksojnë sistemin, barazinë dhe llogaridhënjen, praktika jonë ende ngelet në nivel formal dhe të pjesshëm, duke lënë një diferencë të madhe midis aspiratës dhe realitetit.



¹⁷ Council of Europe. “Improving Well-Being at School Democratic Schools for All.”
<https://www.coe.int/en/web/campaign-free-to-speak-safe-to-learn/improving-well-being-at-school>

4 PRESPEKTIVAT E AKTORËVE TË NDRYSHËM MBI SHËRBIMET PSIKOLOGJIKE NË SHKOLLË

4.1 Perspektiva e nxënësve mbi shërbimin psikologjik në shkollë

Përmes intervistave me nxënës të ciklit 9-vjeçar dhe atij të mesëm, doli në pah një tablo shumëdimensionale mbi mënyrën se si perceptohet dhe funksionon shërbimi psikologjik në shkollë. Në përgjithësi, nxënësit deklaruan se e dinë që në shkollën e tyre ka një psikolog dhe se kjo figurë u është prezantuar në klasë, duke i informuar se mund të drejtohen tek ajo në rast shqetësimesh apo nevojë për konsultim. Kjo tregon se ekziston një **informim bazë** dhe një **prani institucionale** e shërbimit psikosocial në shkollë. Megjithatë, nga përgjigjet rezulton se **aksesueshmëria reale dhe besueshmëria** e këtij shërbimi mbetet e kufizuar. Shumë nxënës shprehën hezitim për t'iu drejtuar psikologut për shkak të frikës se informacioni i ndarë nuk do të mbetet konfidencial dhe mund të bëhet i ditur tek mësuesit apo shokët e klasës. Ky perceptim, i kombinuar me **stigmën shoqërore që ende përndjek shëndetin mendor**, bën që vizita tek psikologu të shihet si tregues problemi dhe jo si një burim normal mbështetjeje. Një tjetër element i shprehur nga nxënësit lidhet me **mjedisin fizik** ku zhvillohet shërbimi. Zyra e psikologut shpesh perceptohet si jo-miqësore, me pamje të ngurtë ose zyrtare që ngjason me "hetim" apo "gjyq". Ky ambient nuk krijon ndjenjën e sigurisë emocionale që është thelbësore për të nxitur hapjen dhe komunikimin e lirë. Vetë nxënësit sugjerojnë që zyra të ketë një paraqitje më të ngrohtë dhe mikpritëse, që ta bëjë më të lehtë qasjen. Nga intervistat gjithashtu rezulton se nxënësit presin që **psikologu të jetë më i dukshëm dhe i integruar në jetën e përditshme të shkollës**, përtej orareve të zyrës. Ata e lidhin besueshmërinë me praninë e vazhdueshme dhe përfshirjen në aktivitete edukative, ku psikologu mund të shfaqet si figurë e afërt, e kuptueshme dhe jo vetëm si funksionar i jashtëm. Mungesa e prezencës së rregullt shihet si arsye pse shumë nxënës nuk i kërkojnë ndihmë psikologut, edhe kur kanë nevojë. Në të njëjtën kohë, disa nxënës kryesisht në Tiranë ose qytetet



afër njohin dhe **elementet pozitive** ka psikologë që perceptohen si të çiltër, më të afërt dhe më mikpritës. Në këto raste, nxënësit shprehin se ndihen më komod për të komunikuar dhe e shohin psikologun si mbështetje reale për bullizmin, konfliktet apo çështjet personale. Ky dallim tregon se **cilësia e marrëdhënies psikolog–nxënës** mund të bëjë diferencën ndërmjet një figure formale dhe një mbështetje të vërtetë. Sipas nxënësve, sfidat kryesore që ata përballen dhe për të cilat do të donin mbështetje përfshijnë **bullizmin, ndjenjën e izolimit, presionin shoqëror, vetminë, konfliktet që lindin nga rrjetet sociale, si dhe stresin akademik dhe familjar**. Ata theksojnë se psikologu mund të luajë një rol më aktiv në menaxhimin e këtyre problematikave duke ofruar seanca edukative, duke krijuar miqësi dhe duke ndërtuar siguri emocionale. Në disa raste nxënësit raportuan se për shkak të **mungesës së besimit ose stigmatizimit**, ata kanë zgjedhur alternativa të tjera, përfshirë edhe përdorimin e platformave online si ChatGPT për të marrë këshilla konfidenciale, të cilat i bëjnë të ndihen më të sigurt. Kjo është një **sinjal alarmi** për shërbimin psikosocial në shkolla dhe jo vetëm, por njëkohësisht edhe një tregues i qartë i **nevojës për rritje të aksesueshmërisë dhe konfidencialitetit**. Pra, perspektiva e nxënësve tregon se **prania e psikologut në shkollë është e njohur dhe potencialisht e vlefshme**, por ndikimi i saj mbetet i kufizuar nga mjedisi fizik, stigmën, mungesën e konfidencialitetit dhe prezencës së qëndrueshme. Sidoqoftë, aty ku psikologu ka arritur të krijojë një marrëdhënie të afërt, të besueshme dhe të dukshme, nxënësit e shohin qartë vlerën e shërbimit psikosocial. Kjo sugjeron se politika publike duhet të përqendrohet në **standardizimin e kushteve, forcimin e konfidencialitetit dhe promovimin e rolit aktiv të psikologut në jetën e shkollës**, për të kthyer perceptimin e shërbimit nga formalitet në mbështetje reale.

4.2 Perspektiva e mësuesve mbi shërbimet psikologjike në shkollë

Në intervistat me mësuesit, vërehet se perceptimi i tyre ndaj shërbimit psikosocial mbetet i dyzuar. Kritikat janë të shumta dhe të



drejtpërdrejta. Mësuesit e përshkruajnë bashkëpunimin me psikologun si minimal, shpesh i kufizuar në takime formale ose në ndërhyrje të rastit. Figura e psikologut shihet si e paqartë dhe e largët, duke mos u prezantuar si një aktor i natyrshëm i jetës shkollore. Siç u shpreh njëri prej tyre: *"Nxënësit nuk e njohin dhe nuk ia dinë funksionin. Ai nuk duhet të shihet si mësues zëvendësues, por si mbështetje reale."* Ky perceptim i dobët ndikon drejtpërdrejt në efektivitetin e shërbimit. Një tjetër kritikë lidhet me mungesën e trajnimeve cilësore. Shumë mësues raportojnë se trajnimet që u ofrohen janë të përsëritura, shpesh vetëm mbi bullizmin, ndërkohë që realiteti në klasë është shumë më kompleks. Një mësues tha: *"Trajnuesit kanë ardhur vetëm për të kryer detyrën dhe janë larguar, nuk ka qenë asgjë interaktive."* Kjo tregon një hendek të madh mes politikave të shpallura dhe praktikës në terren. Në marrëdhëniet me prindërit, psikologët shpesh perceptohen si të dobët në krijimin e besimit. Ka raste kur prindërit e shohin psikologun si kërcënim për privatësinë e fëmijës, duke u mbështetur në raste joetike ku informacionet e ndjeshme janë bërë "biseda kafeneje". Kjo ka forcuar tabunë dhe frikën e dërgimit të fëmijëve te psikologu. Një pjesë e mësuesve theksojnë gjithashtu se, ndonëse ekziston një protokoll për zgjidhjen e rasteve, në praktikë ai shpesh mbetet formal ose nuk zbatohet me rigorozitet. Për këtë arsye, shumë prej tyre ndihen të detyruar të zgjidhin vetë problematikat në klasë, duke marrë role që nuk u takojnë. Një mësuese tregoi se kishte krijuar një fletore ku regjistronte çdo rast, mënyrën si u trajtua dhe kush u përfshi, një praktikë individuale që zëvendësonte boshllëkun që lë mospërfshirja aktive e psikologut. Megjithatë, tabloja nuk është vetëm negative. Shumë mësues tregojnë se kanë parë raste konkrete ku psikologu ka ndikuar pozitivisht. Ka situata kur psikologu ka ndërhyrë në konflikte nxënësish, ka komunikuar me prindërit dhe ka zgjidhur problematika të rënda. Një mësuese rrëfeu: *"Kur s'kam qenë mirë vetë, nga problemet familjare, psikologia më është afruar dhe më ka lënë të kuptoj që është aty edhe për mua."* Kjo tregon se kur psikologu është i përfshirë realisht, ndikimi shtrihet përtej nxënësve, duke kontribuar edhe në mirëqenien e



mësuesve. Kontrasti mes Tiranës dhe rretheve del i qartë. Në kryeqytet dhe qytetet e mëdha, prania e psikologut është më e dukshme, ndonëse problemet ekzistojnë, aksesueshmëria dhe infrastruktura janë më të mira, pasi ka dhe kërkesë llogaridhënie më të lartë. Në zonat periferike, përkundrazi, stigma është më e fortë, roli i psikologut shpesh nuk njihet dhe mungesa e resurseve e bën punën më të vështirë. Një mësues tha: *“Në një qytet të vogël të gjithë flasin për problematika, jo për pasione ose libra dhe aty lind ankthi e frika.”* Kjo dëshmon se sfidat nuk janë vetëm profesionale, por edhe kulturore. Një element interesant që del nga analiza është fakti se jo të gjithë psikologët janë të mbingarkuar. Ndërsa disa e ndajnë kohën mes disa shkollave dhe kanë volum pune të madh, të tjerë janë të pranishëm në shkollë, por mbeten pasivë, duke mos u përfshirë në mënyrë të dukshme në jetën e përditshme të saj. Ky dualitet e bën shërbimin jo të barabartë në disa shkolla, ku psikologu shihet si i padukshëm dhe jo funksional, ndërsa në të tjera si mbështetje reale. Nga perspektiva e mësuesve, shërbimi psikosocial shihet si një potencial i madh, por i fragmentuar. Kritikata kryesore lidhen me formalizmin e protokolleve, mungesën e bashkëpunimit të rregullt, trajnime të pamjaftueshme dhe mungesë besimi nga prindërit. Megjithatë, aty ku psikologu është aktiv dhe i përfshirë, përfitimet janë të dukshme mbështetje për nxënësit, lehtësim i punës së mësuesve dhe ndihmë edhe për mirëqenien e tyre personale. Krahasimi mes Tiranës dhe rretheve tregon qartë se shkalla e funksionalitetit të shërbimit ndryshon ndjeshëm sipas kontekstit. Për më tepër, fakti që disa psikologë janë të mbingarkuar, ndërsa të tjerë mbeten pasivë, tregon për mungesë koherence dhe mekanizmesh llogaridhënie. Në këtë kuadër, sfida nuk është vetëm të rritet numri i psikologëve, por të garantohet që roli i tyre të zbatohet me standarde të njëjta, duke i bërë ata aktorë realë dhe jo formalë të jetës shkollore.

4.3 Perspektiva e psikologëve

Në intervistat e zhvilluara me psikologët shkollore del qartë një panoramë komplekse e shërbimeve psikosociale, ku realiteti i



përditshëm përshkohet nga sfida të shumta, por edhe nga përpjekje individuale për të ruajtur funksionalitetin e shërbimit. Një nga problemet më të theksuara lidhet me mungesën e infrastrukturës adekuate. Disa psikologë treguan se mbulojnë dy shkolla dhe se në njërin prej tyre nuk kanë as zyrë të dedikuar, duke u detyruar të përdorin përkohësisht zyrën e drejtorit. Kjo situatë jo vetëm cënon konfidencialitetin, por krijon edhe një ambient aspak mikpritës për nxënësit. Edhe aty ku ekziston një zyrë, kushtet janë të pamjaftueshme, mungesë interneti, pajisjesh bazike dhe elementësh të domosdoshëm për ruajtjen e dokumentacionit. Një prej psikologëve e përshkroi këtë qartë se vetëm këtë vit kishte marrë kompjuterin e parë për punë, ç'ka tregon qartë nivelin e vonuar të mbështetjes institucionale. Këto mangësi ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e punës dhe e kthejnë shërbimin shpesh në një formalitet. Një tjetër sfidë madhore lidhet me qëndrimin e prindërve, ku paragjykimi dhe neglizhenca shpesh përbëjnë pengesën kryesore për funksionimin e shërbimit. Psikologët kanë raportuar raste kur prindërit kanë refuzuar që fëmijët e tyre të takohen me specialistin, duke e parë këtë proces si stigmë apo si një tregues dështimi familjar. Në zonat e vogla, ku komunitetet janë më të mbyllura, kjo problematikë është edhe më e theksuar, duke izoluar psikologun dhe duke e kufizuar rolin e tij në ndërhyrjet e nevojshme. Në vend që prindërit të shihen si aleatë në procesin e ndërhyrjes, shpesh ata kthehen në një barrierë të fortë që e vështirëson punën. Marrëdhëniet me stafin mësimor gjithashtu paraqiten kontraktore. Në disa raste, bashkëpunimi është i plotë dhe mësuesit ndihmës e shohin psikologun si partner të domosdoshëm për mbështetjen e nxënësve me aftësi të kufizuara. Megjithatë, mësuesit e lëndëve shpesh hezitojnë të marrin përgjegjësi dhe e perceptojnë shërbimin psikosocial si një element dytësor në jetën e shkollës. Një psikolog tha hapur se megjithëse ekzistojnë protokolle për bashkëpunimin, në praktikë shumë prej tyre mbeten vetëm në letër dhe nuk ndiqen me seriozitet. Kjo situatë shpesh bën që problematikat e nxënësve të zgjidhen në mënyrë të fragmentuar, pa koordinim mes aktorëve të shkollës. Megjithatë, intervistat nxorën në pah edhe



praktika pozitive. Në disa institucione, drejtuesit kanë treguar mbështetje të fortë dhe janë kujdesur që psikologët të jenë të përfshirë në çdo rast problematik. Njëri prej tyre deklaroi se drejtori e njoftonte për çdo çështje, duke e konsideruar pjesë të pandashme të procesit vendimmarrës. Një tjetër praktikë e dobishme ishte përdorimi i anketimeve anonime për nxënësit, të cilat i kanë ndihmuar psikologët të kuptojnë më mirë gjendjen emocionale dhe të parandalojnë situata problematike. Gjithashtu, disa psikologë kanë luajtur rol të rëndësishëm në këshillimin e karrierës, megjithëse vetë theksuan se mungesa e klasave burimore dhe e resurseve kufizon shumë këtë dimension të punës së tyre. Diferencat mes kryeqytetit dhe rrethëve janë një tjetër element që del qartë. Në Tiranë dhe qytetet kryesore, kushtet e punës janë disi më të mira dhe ndërgjegjësimi mbi rëndësinë e shëndetit mendor është më i lartë. Për pasojë, bashkëpunimi me prindërit dhe me stafin është më i prekshëm dhe më i qëndrueshëm. Ndërkohë, në zonat rurale situata është më problematike, jo vetëm për shkak të mungesës së infrastrukturës, por edhe për shkak të mentalitetit paragjykses dhe të mungesës së mbështetjes institucionale. Në këto zona, psikologët shpesh ndihen të izoluar, me pak mjete për të ushtruar profesionin e tyre dhe të mbingarkuar për shkak të mbulimit të disa shkollave njëherësh. Nga analiza del se shërbimi psikosocial në shkollë vuan nga një paradoks, disa psikologë janë të mbingarkuar, duke mbuluar disa institucione dhe duke u përpjekur të përballojnë fluksin e rasteve, ndërsa të tjerë mbeten pasivë, të kufizuar në funksione formale pa ndikim real tek nxënësit. Kjo pabarazi e bën shërbimin jo të standardizuar dhe lë hapësirë për dyshime mbi efektivitetin e tij. Megjithatë, kur ekziston vullnet profesional dhe mbështetje nga drejtuesit, shërbimi arrin të funksionojë si një mekanizëm i rëndësishëm i shkollës, duke ndikuar pozitivisht në mirëqenien e nxënësve dhe në klimën institucionale. Për këtë arsye, është e domosdoshme që politikat publike të fokusohen jo vetëm në rritjen e numrit të psikologëve, por edhe në sigurimin e kushteve të barabarta, mbështetjes së vazhdueshme profesionale dhe mekanizmave të qartë monitorimi, për



të garantuar që shërbimi psikosocial të jetë realisht i dobishëm dhe jo thjesht një formalitet.

4.4 Perspektiva e pedagoges së masterit në psikologji shkollore

Intervista me pedagogen e Masterit në Psikologji Shkollore pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës, ofroi një analizë të detajuar mbi gjendjen aktuale të shërbimeve psikosociale, si edhe mbi përgatitjen profesionale të studentëve që synojnë të ushtrojnë këtë profesion. Një nga shqetësimet kryesore që ajo theksoi lidhet me **mungesën e një protokolli të unifikuar dhe të detajuar**. Sipas saj, aktet ligjore dhe udhëzimet ekzistuese janë të qarta dhe të bollshme, por nuk japin një udhëzues praktik hap pas hapi për rolin e psikologut dhe punonjësit social në shkollë: *“Janë shumë dokumente, por jo të përmbledhura sesi janë hapat që vijnë, një psikolog shpeshherë futet në shkollë dhe ndjehet i dyzuar mbi rolin që duhet të marrë.”* Kjo krijon pasiguri profesionale dhe hapësirë për interpretime të ndryshme në terren, sidomos në shkollat ku mungon një traditë e fortë e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve. Ajo theksoi gjithashtu problemin e **mos përputhjes mes ideale dhe reales**. Ndërsa ligji dhe udhëzimet parashikojnë një sistem të mirëorganizuar, realiteti shpesh karakterizohet nga mbyllja e rasteve brenda shkollës, pa i çuar ato drejt një mekanizmi më të gjerë referimi. Kjo nuk lidhet me mungesë vullneti nga ana e psikologëve, por me kufizimet që vendosin hierarkitë dhe praktikat institucionale. Për pasojë, në shumë raste problemet nuk ndiqen deri në fund, duke cënuar efektivitetin e ndërhyrjes. Një tjetër pikë kritike që u ngrit lidhet me **praktikat profesionale dhe përfshirjen e studentëve**. Ndryshe nga mësuesit, të cilët kanë një skemë të qartë financimi për periudhën e praktikës, studentët e psikologjisë shpesh duhet të mbulojnë vetë sigurimet shoqërore dhe nuk kanë një pozicion të dedikuar praktikantësh në shkolla publike. Kjo e bën integrimin e tyre më të vështirë dhe, në shumë raste, i dekurajon të ndjekin profilin e psikologut shkollos. Siç u shpreh pedagogia: *“Psikologët klinikë kanë më shumë hapësira praktike në spitale apo qendra, ndërsa psikologët*



shkollorë e kanë shumë më të limituar.” Një pjesë e rëndësishme e analizës lidhet edhe me **raportin mes Ministrisë së Arsimit dhe Urdhrit të Psikologut**. Ajo shpjegoi se licencimi është bërë një kriter i detyrueshëm për të punuar në shkollë, çka ka forcuar rolin rregullator të Urdhrit. Në Tiranë ky bashkëpunim funksionon relativisht mirë, me koordinim nga DRAP dhe ZVA, ndërsa në rrethe mbeten dyshime nëse e njëjta mbështetje ofrohet me të njëjtin intensitet. Ky kontrast përforcon idenë se ekziston një ndarje e qartë mes qendrës dhe periferisë, ku profesionistët e rinj shpesh hasin më shumë vështirësi në terren. Sa i përket **përgatitjes akademike**, ajo theksoi se programi i Masterit në Psikologji Shkollore është tashmë i njohur nga EFPA dhe i përputhur me standardet evropiane, gjë që u jep studentëve një licencë të vlefshme edhe jashtë Shqipërisë. Praktikant profesionalë që zgjasin një semestër konsiderohen të dobishme, pasi realizohen në bashkëpunim me DRAP-et dhe ndjekën nga pedagogët. Megjithatë, sfidat fillojnë kur studentët kalojnë nga faza e praktikës në fazën e punës reale, ku duhet të përballen me aktorë të ndryshëm si drejtorë, prindër apo mësues që shpesh nuk i njohin apo nuk i pranojnë lehtë rekomandimet e tyre. Në analizën e saj u nënvizua edhe **mospërputhja mes profilizimeve**. Për shkak të mungesës së psikologëve shkollorë, shpesh pozicionet mbulohen nga psikologë me profil klinik, të cilët, edhe pse të aftë profesionalisht, nuk kanë njohuri të mjaftueshme për rregulloret, dinamikën shkollore apo bashkëpunimin me aktorët e sistemit arsimor. Kjo, sipas saj, dëmton cilësinë e shërbimit dhe forcon nevojën për profilizimin e qartë të psikologëve shkollorë. Nga ana pozitive, pedagogia shprehu bindjen se **e ardhmja e shërbimeve psikosociale ka premisa të mira**. Ajo theksoi se figurës së psikologut po i jepet gjithnjë e më shumë prioritet dhe se kontrollet e shtuar mbi cilësinë e shërbimeve kanë rritur standardet e etikës profesionale. “Nuk është çështje respekti, është çështje nevojë” tha ajo, duke nënvizuar se psikologu po kthehet në një figurë të domosdoshme për funksionimin e shkollës. Në mënyrë sintetike, perspektiva e pedagoges tregon një **dinamikë kontradiktore** nga njëra anë, ekzistojnë baza të forta ligjore



dhe akademike që e mbështesin zhvillimin e profesionit, nga ana tjetër, pengesat praktike dhe kulturore mungesa e protokolleve, burokracitë institucionale, hezitimi i prindërve, dhe hendeku qendër-periferi vazhdojnë ta bëjnë të vështirë zbatimin e plotë të këtij vizioni.

5 VLERËSIM KRITIK DHE ANALIZË

Nga analiza e kornizës ligjore, standardeve ndërkombëtare dhe perceptimeve të aktorëve kryesorë (nxënës, mësues, psikologë dhe pedagogë), del qartë një kontrast i thellë ndërmjet asaj që parashikohet në dokumentet zyrtare dhe asaj që përjetohet realisht në terren. Arkitektura normative shqiptare është e plotë: Ligji nr. 69/2012 dhe aktet nënligjore përkatëse, përfshirë Urdhrat nr. 313/2020, nr. 110/2025 dhe nr. 483/2025, vendosin një bazë të qartë për funksionimin e shërbimit psikosocial. Po ashtu, ASCAP ka ofruar manuale pune dhe Kornizën e Vlerësimit (2025), që parashikojnë tregues strukturë–proces–rezultat dhe kërkojnë prova konkrete të performancës. Në letër, sistemi përkon me rekomandimet e OBSH-së dhe UNICEF-it për qasje gjithë-shkollore dhe matje të cilësisë, duke afruar Shqipërinë me standardet evropiane. Megjithatë, ky rregullim mbetet kryesisht procedural, pa tregues të matshëm mbi rezultatet dhe pa mekanizma të fortë supervizimi, duke lënë hapësirë për përputhshmëri formale më shumë se sa për ndikim real. Statistikat e fundit ilustrojnë qartë këtë hendek. Në vitin shkollor 2023–2024 u punësuan 1005 psikologë dhe punonjës socialë, 30% më shumë se një vit më parë, por secili prej tyre mbulon mesatarisht 506 nxënës një shifër që i afrohet rekomandimeve të NASP (1:500), por që në mungesë të kushteve adekuate dhe mbështetjes institucionale nuk përkthehet në cilësi shërbimi. Raporti i monitorimit i Qëndresës Qytetare¹⁸ thekson se objektivat e Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021–2026 janë hartuar me terma të përgjithshëm, pa indikatorë të qartë matës, duke e bërë të pamundur vlerësimin e impaktit real të

¹⁸ Qëndresa Qytetare. (2024, tetor). Raporti Monitorimi: Strategjia Kombëtare e Arsimit <https://qq.com.al/wp-content/uploads/2024/10/RAPORT-MONITORIMI-STRATEGJIA-KOMBETARE-E-ARSIMIT-PERFUNDIMTAR.pdf>



masave të marra. Në të njëjtën linjë, raporti i Terre des hommes¹⁹ thekson mangësitë e kushteve infrastrukturore, mungesë hapësirash të përshtatshme, mungesë pajisjesh bazë dhe mbështetje të pakët për referime funksionale, veçanërisht në zonat rurale. Këto të dhëna tregojnë se, edhe pse numri i specialistëve është rritur, pabarazitë territoriale dhe boshllëqet në resurse e bëjnë shërbimin jo të standardizuar. Intervistat me aktorët kryesorë e konfirmojnë këtë realitet. Nxënësit raportojnë njohje formale të figurës së psikologut, por hezitim për t'u drejtuar për shkak të mungesës së konfidencialitetit dhe stigmatizimit. Mësuesit shprehën se bashkëpunimi me psikologët është shpesh minimal dhe jo i institucionalizuar, ndërkohë që trajnimet që marrin mbeten të përsëritura dhe jo të përshtatura me kompleksitetin e situatave. Psikologët vetë nënvizojnë se mbingarkesa, mungesa e infrastrukturës dhe rezistenca e prindërve pengojnë funksionimin efektiv të shërbimit. Pedagogia e Masterit ngre shqetësimin e mungesës së një protokolli të unifikuar praktik dhe të profilizimit të qartë të psikologut shkollor, duke evidentuar se shpesh pozicionet mbulohen nga profesionistë të fushës klinike që nuk janë të përgatitur për dinamikën e shkollës. Krahasuar me standardet ndërkombëtare, ku theksi vendoset jo vetëm te raportet numerike, por edhe te një qasje e integruar dhe gjithëpërfshirëse, Shqipëria mbetet prapa. OBSH dhe UNICEF kërkojnë që shërbimi psikosocial të përfshihet në politikat e shkollës, në kurrikulën e aftësive jetësore, në mekanizmat e referimit dhe monitorimit, si dhe të mbështetet me financim të qëndrueshëm. Në praktikë, shkollat shqiptare shpesh nuk kanë as hapësira konfidenciale, as ura funksionale referimi me shërbimet shëndetësore dhe sociale. Kjo e bën shërbimin të fragmentuar dhe shpesh formal, në kundërshtim me parimet e “Whole-School Approach”. Një element i ri që ka dalë në pah është përdorimi i platformave digjitale si ChatGPT nga nxënësit, të cilët për shkak të mungesës së besimit dhe aksesit, i



¹⁹ Terre des hommes & MASR. (2021). Raporti vlerësimit të nevojave për punonjësit e njësisë psiko-sociale në shkolla
https://tdh-albania.org/sites/default/files/2022-07/Raporti%20vleresimit%20te%20nevojave%20Draft%20Final%2009.08.2021_30.08.2021_Clean_MGR.pdf

drejtohen këtyre alternativave për këshillim konfidencial. Kjo praktikë është shqetësuese, pasi rasti i një 16-vjeçari në Kaliforni²⁰, i cili mori 'këshilla' të rrezikshme nga ChatGPT që e çuan drejt vetëdëmtimit, tregon rreziqet reale të përdorimit të mjeteve të tilla pa mbikëqyrje profesionale. Incidentet e tjera të raportuara në media, që kanë nxitur edhe ndërhyrje në politikat e sigurisë të kompanive zhvillues, nënvizojnë domosdoshmërinë që shkollat të ofrojnë shërbime psikosociale të sigurt dhe të besueshme, në mënyrë që nxënësit të mos detyrohen të kërkojnë mbështetje në burime jo të certifikuara. Kjo është një thirrje për forcimin e konfidencialitetit dhe të aksesueshmërisë në nivel shkolle, si një masë parandaluese kundër rreziqeve që sjell përdorimi i alternativave të pasigurt. Pra ky vlerësim kritik tregon se Shqipëria ka një bazë të konsoliduar ligjore dhe profesionale për shërbimin psikosocial në shkollë, e cila në teori përputhet me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, në praktikë, shërbimi mbetet i fragmentuar, i pabarabartë dhe shpesh formal. Hendeku ndërmjet "normës" dhe "realitetit" shfaqet në çdo nivel, nga ngarkesa numerike dhe kushtet infrastrukturore, te mungesa e besimit dhe moszbatimi i plotë i protokolleve. Për ta tejkaluar këtë, nevojiten tre shtylla kyçe, standarde të detyrueshme cilësie dhe ngarkese për çdo shkollë, supervizim i rregullt dhe auditim i bazuar në rezultate, si dhe ndërtimi i urave funksionale me shërbimet shëndetësore dhe sociale. Vetëm në këtë mënyrë shërbimi psikosocial do të kalojë nga një prezencë formale në një instrument real mbështetje për nxënësit dhe komunitetin shkollor.

MUNGESA E TË DHËNAVE DHE TRANSPARENCA INSTITUCIONALE

Mungesa e të dhënave dhe transparenca institucionale përbën një nga sfidat më serioze për funksionimin e shërbimeve psikosociale në shkollë. Ministria e Arsimit, edhe pse ka kthyer përgjigje ndaj kërkesave

²⁰ Gazeta Tema. (n.d.). Çfarë i tha ChatGPT 16-vjeçarit që e çoi drejt vetëvrasjes? Detaje tronditëse nga biseda.
<https://www.gazetatema.net/lifestyle/fare-i-tha-chatgpt-16-vjecarit-qe-e-coi-drejt-veterasjes-detaje-trondi-i517043>



për informacion, nuk ka ofruar statistikat e plotë dhe të detajuara mbi tregues thelbësorë si: raporti psikolog–nxënës në nivel shkolle, numri i institucioneve pa psikologë të emëruar, apo kushtet e punës së punonjësve psikosocial. Ky boshllëk informacioni nuk është vetëm një problem teknik, por një tregues i mungesës së llogaridhënies institucionale. Pa këto të dhëna bazë, bëhet e pamundur të vlerësohet realisht situata, të hartohen politika të bazuara në evidenca dhe të monitorohet ndikimi i masave të ndërmarra. Për më tepër, Qëndresa Qytetare i është drejtuar zyrtarisht Ministrisë me kërkesa për transparencë, por përgjigjet e marra kanë qenë të pjesshme dhe nuk kanë adresuar kërkesat konkrete për statistikat e mësipërme. Kjo tregon një kulturë institucionale që preferon të mbajë informacionin të fragmentuar dhe të paaksesueshëm, duke lënë politikëbërjen dhe opinionin publik pa mjetet e duhura për të gjykuar mbi efektivitetin real të shërbimeve psikosociale në shkolla. Në këto kushte, çdo diskutim mbi përmirësimin e shërbimeve mbetet i cunguar, pasi nuk mbështetet mbi një bazë të plotë të dhënash.



GJETJET KRYESORE

- Raporti psikolog–nxënës është i lartë (mesatarisht 1:506), mbi standardet e rekomanduara ndërkombëtare. Në disa zona rurale psikologët mbulojnë më shumë se një shkollë, ndërsa në të tjera mbeten pasivë ose jo-funksionalë.
- Infrastruktura është e pamjaftueshme, ku raportohet për mungesë zyrash të dedikuara, pajisjeve bazike dhe kushteve që garantojnë konfidencialitetin.
- Korniza ligjore ekziston, por zbatimi i protokolleve mbetet formal, shumë raste mbyllen brenda shkollës pa ndjekur mekanizmat e referimit.
- Bashkëpunimi mes aktorëve është i fragmentuar, mësuesit shpesh ndihen të vetëm në menaxhimin e problematikave, ndërsa prindërit shfaqin paragjykime dhe hezitime.
- Supervizimi profesional dhe mbështetja institucionale janë të kufizuara, shpesh reduktohen në procedura formale pa ndikim real.
- Ka dallime të dukshme midis Tiranës dhe qyteteve të tjera, në kryeqytet shërbimi është më i aksesueshëm, ndërsa në zonat rurale stigma dhe mungesa e burimeve e dobësojnë funksionalitetin.
- Nxënësit shpesh nuk e shohin psikologun si figurë të besueshme, për shkak të mungesës së konfidencialitetit dhe prezencës së fiktive në jetën e shkollës.
- Në mungesë të aksesit real, disa nxënës përdorin platforma online si ChatGPT për të marrë këshilla, duke ekspozuar veten ndaj rreziqeve të dokumentuara në raste ndërkombëtare.



REKOMANDIMET

- Zbatimi i plotë i protokolleve dhe forcimi i mekanizmave të referimit për rastet problematike.
- Ulja e raportit psikolog–nxënës në përputhje me standardet ndërkombëtare (1:500 ose më pak), duke garantuar shpërndarje të barabartë në territor.
- Sigurimi i infrastrukturës bazike, si zyra të dedikuara, kushte për konfidencialitet dhe pajisje të nevojshme teknologjike.
- Rritja e cilësisë së trajnimeve për mësuesit dhe psikologët, me fokus në temat aktuale të shëndetit mendor dhe ndërhyrjeve praktike.
- Krijimi i mekanizmave të rregullt për supervizim profesional dhe mbështetje institucionale efektive.
- Futja e praktikantëve të psikologjisë shkollore në skema të ngjashme me ato të mësuesve, për të lehtësuar integrimin në tregun e punës.
- Profilizimi i qartë i psikologëve shkollorë për të shmangur mbulimin nga profesionistë të fushave të tjera (klinike).
- Ulja e kontrastit mes qendrës dhe periferisë përmes fondeve të dedikuara për zonat rurale dhe shkollat në nevojë.
- Forcimi i fushatave për uljen e stigmatizimit dhe ndërtimin e besimit të prindërve dhe nxënësve te psikologu shkollor.
- Ndërtimi i mekanizmave të sigurt dhe të kontrolluar për përdorimin e platformave digjitale, duke parandaluar rreziqet e lidhura me mbështetjen e pasigurt online.



#QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al